# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-433494**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Ky ishte futboll i vërtetë”/ Seedorf i mahnitur nga spektakli në Real Madrid-Inter: Nuk mbaj mend të jem kënaqur kaq shumë që nga… |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/09/ky-ishte-futboll-i-vertet-seedorf-i-mahnitur-nga-spektakli-ne-real-madrid-inter-nuk-mbaj-mend-te-jem-kenaqur-kaq-shume-qe-nga/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 15:32:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 9 shtator 2026, 15:23:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 9 shtator 2026, 15:22:00 UTC → 9 shtator 2026, 15:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bbb716fd7a4026f55237bd9163437f8a0673fd0f614a356d034a35e5da1b17a1` |
| TEKSTI | `9c47ce8046a1d3d73822748f4af50ddc2b26ba3e47b10e803e40538fc929cd5a` |
| PAMJA | `9893fcfe67c5bc6b8503ae6ea174f8195219cf716ac9e3c42a6e483211f11f72` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `23812580081268bebed43ffead216401707d799f3e5507efcb83ddaee4fbb60e` |
| E MËPARSHMJA | `043ebe628fccfc41c7f8fbbe7525d15c818eb4e3f304f700ef118e4767ec3d33` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/23812580081268bebed43ffead216401707d799f3e5507efcb83ddaee4fbb60e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# "Ky ishte futboll i vërtetë"/ Seedorf i mahnitur nga spektakli në Real Madrid-Inter: Nuk mbaj mend të jem kënaqur kaq shumë që nga…

09/09/2026 17:23

Liga e Kampionëve e nisi sezonin e ri me një përballje spektakolare mes Real Madridit dhe Interit, e cila i përmbushi plotësisht pritshmëritë.

Dueli në "Santiago Bernabéu" dhuroi emocione, ritëm dhe raste të shumta, duke u shndërruar në një nga ndeshjet më të komentuar të mbrëmjes evropiane.

Edhe José Mourinho e përkufizoi sfidën si një ndeshje të çmendur, duke theksuar se rezultati mund të kishte marrë përmasa krejtësisht të tjera.

*"Ishte një ndeshje e çmendur. Mund të kishte qenë 5-0 për ne, 5-5, 6-5 apo 7-5"*, u shpreh Mourinho, duke nënvizuar karakterin e hapur dhe spektakolar të përballjes.

Një tjetër figurë e njohur e futbollit evropian, Clarence Seedorf, mbeti veçanërisht i impresionuar nga ajo që pa në Madrid. Ish-mesfushori holandez e cilësoi duelin si një shembull të futbollit të nivelit më të lartë në Champions League.

*"Ky ishte futboll i vërtetë i Ligës së Kampionëve. E shijova çdo moment të ndeshjes. Interi ishte i shkëlqyer"*, deklaroi Seedorf.

Ai vlerësoi në veçanti organizimin taktik të skuadrës së Cristian Chivut, duke theksuar mënyrën se si zikaltërit kontrolluan topin dhe krijuan hapësira ndaj një kundërshtari të madh.

*"Taktikisht, Interi është një nga ekipet më të mira që kam parë këtë sezon. Mënyra se si e mbajtën topin, e lëvizën Real Madridin dhe gjetën hapësira tregonte qartë se çfarë donin të bënin. Ata nuk shkuan në 'Bernabéu' të frikësuar nga Reali"*, shtoi ish-lojtari.

Por komplimentet e Seedorf nuk munguan as për madrilenët. Sipas tij, Real Madridi tregoi të njëjtin nivel cilësie, duke refuzuar të binte në kurthin taktik të Interit.

*"Real Madridi ishte gjithashtu i shkëlqyer, sepse e kuptoi lojën që Interi donte të luante dhe refuzoi ta luante sipas kushteve të tyre. Sa herë që Reali fitonte topin, kishe ndjesinë se diçka mund të ndodhte. Interi mund të sulmonte për dy minuta, ndërsa Real Madridit i duheshin vetëm dhjetë sekonda për të arritur në anën tjetër"*, tha Seedorf.

Ish-futbollisti holandez e vlerësoi veçanërisht faktin se të dyja skuadrat nuk u mjaftuan vetëm me mbrojtjen apo kontrollin e lojës.

*"Nuk ishte një ekip që sulmonte dhe tjetri që përpiqej të mbijetonte. Ishin dy ekipe të shkëlqyera që i bënë vetes pyetje krejtësisht të ndryshme gjatë gjithë natës"*, u shpreh ai.

Seedorf shkoi edhe më tej në vlerësimin e tij, duke e krahasuar këtë përballje me një tjetër duel të madh të sezonit të kaluar.

*"Sinqerisht, që nga ndeshja PSG-Bayern sezonin e kaluar, nuk mbaj mend të kem qenë kaq i kënaqur duke parë një ndeshje të Ligës së Kampionëve. Dy ekipe shumë të forta që sulmojnë mirë, mbrohen mirë dhe përpiqen të luftojnë në mënyra krejtësisht të ndryshme. Kjo është kinema"*, përfundoi ai.

**Top Channel**


Champions League »
Roma, pas 7 vitesh është sërish në Champions, Gasperini: Pas Botërorit, kompeticioni më prestigjioz
09/09 17:56
Vëllai i Mbappe shkatërron debutimin në Champios League të Davide Ancelottit, ndërhyn edhe…Kylian
09/09 13:01
Përplasja me Lautaro Martinez dhe 'mesazhi' për Barellan, Huijsen ndez rrjeter sociale dhe juventinët…
09/09 12:44
Galatasaray luan në Champions, Leao thumbon Milanin në konferencën për shtyp
09/09 11:40
Mbrëmje kampionësh në Top Channel, sot Napoli-Arsenal. "Studio Champions League" para dhe pas ndeshjes
09/09 10:59
Pas humbjes në 'Bernabeu, Lautaro Martinez: Dalim me kokën lart, ishim të barabartë me Realin. Por në Champions gabimet kushtojnë shtrenjtë
09/09 09:57
Sport »


Roma, pas 7 vitesh është sërish në Champions, Gasperini: Pas Botërorit, kompeticioni më prestigjioz
09/09 17:56


Foto/ Dikur u kap "mat" me yllin e Realit, influencerja merr hak me… Barcelonën
09/09 16:30
Afrojnë ndeshjet e Nations League, trajneri i Kombëtares Maran, tur evropian për të vëzhguar kuqezinjtë
09/09 14:27
Belgjika, Courtois 'ngrin' karrierën me skuadrën kombëtare deri vitin e ardhshëm
09/09 14:14
Duke ecur në gjurmët e të atit, djali i Kimi Raikkonen i bashkohet programit të të rinjve të Red Bull
09/09 13:53
Përplasja Vlahovic-Skriniar, komunikatë e ashpër e Besiktash kundër procedimit disiplinor ndaj sulmuesit
09/09 13:48
Na ndiqni:
Top Channel Top Channel - Sport @topchannelalbania Top Channel
Video »
Top News- Ngërçi i pagave bllokon gjykatat, gjyqtarët mbledhje urgjente! Bojkot në Tiranë e rrethe
Top News- 'Popull serb ka në Serbi'/ Haxhiu përplaset me deputetin e Listës Serbe
Top Channel/ Rama me drejtuesit politikë në 'Vilën e Kuqe', japin llogari para kryeministrit për…
Top News – 'Pse hesht Rama!'/ Akuzat për trafik armësh, PD: SPAK të hetojë skandalin
Top News- Rregullorja e GJKKO paralizon gjyqet, avokatët bojkotojnë! Shtyhen gjyqe të rëndësishme
Top News – 'Akullore' kanadeze në Durrës/ Kapen në port mbi 100 kilogramë hashash
Sport • KRYESORE


Mbrëmje kampionësh në Top Channel, sot Napoli-Arsenal. "Studio Champions League" para dhe pas ndeshjes


Krahu i djathtë në alarm te Kombëtarja, Maran zbarkon në Skoci për të gjetur "sallaks". Një shkodran është risia për ndeshjet e radhës


Galatasaray luan në Champions, Leao thumbon Milanin në konferencën për shtyp


E mërkura e Champions League/ Napoli-Arsenal në Top Channel, por në fushë janë edhe Barcelona, Liverpool dhe Paris Saint Germain
AEK, trajneri konfirmon dëmtimin e Strakoshës, grumbullimi i portierit të kombëtares në dyshim
Me të lexuarat
Opta parashikon fituesin e Champions League, ja 10 skuadrat favorite. Befasi në listë


Vëllai i Mbappe shkatërron debutimin në Champios League të Davide Ancelottit, ndërhyn edhe…Kylian


Videoja virale, çfarë ndodhi mes Mbappé, Vinicius dhe Cucurella pas sfidës me Interin


Foto/ Dikur u kap "mat" me yllin e Realit, influencerja merr hak me… Barcelonën
Krahu i djathtë në alarm te Kombëtarja, Maran zbarkon në Skoci për të gjetur "sallaks". Një shkodran është risia për ndeshjet e radhës
Galatasaray luan në Champions, Leao thumbon Milanin në konferencën për shtyp
Përplasja me Lautaro Martinez dhe 'mesazhi' për Barellan, Huijsen ndez rrjeter sociale dhe juventinët…


Nga Interi te Mbappé, Mourinho zbulon çfarë e shqetëson dhe çfarë jo


Mbrëmje kampionësh në Top Channel, sot Napoli-Arsenal. "Studio Champions League" para dhe pas ndeshjes


Chivu mbron Martinez pas gafës: Pse duhet ta përmendim? Ai është portier i nivelit të lartë

- Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

- Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

- Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.